



Pranimi / Dorezuar Prilijeno / Prodato Received / Delivered	10 - 11 2020	0	viti god year
Organ / Njësia Org / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtjela Pulog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTICK	2540/2020		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.271/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.271/2020 të datës 15.09.2020 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] me adrese banimi Rr. "Fehmi Agani" nr.60/A, nga Komuna e Gjakovës, kundër Vendimit me Nr.01Nr.070/01-13588 të datës 24.07.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në çështjen juridike "kërkese nga marrëdhënia e punës duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 09.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.271/2020 e datës 15.09.2020 e parashtruar nga ankuesi [REDACTED].
- II. SHFUQIZOHET Vendimi me numër Nr.01Nr.070/01-13588 i datës 24.07.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Gjakovës
- III. MBETET ne fuqi përshkrimi detyrave të punës së ankuesit sipas Akt emërimit me numër 01Nr112-143/15 të datës 12.03.2012.
- IV. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Gjakovës dhe Menaxheri i Personelit në Komunën e Gjakovës për zbatimin e këtij vendimi, në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesin [REDACTED] i punësuar sipas Akt emërimit të datës 12.03.2012 në pozitën "Bashkëpunëtor profesional" në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Gjakovës, me vendimin e datës 08.05.2020, Kryetari i Komunës së Gjakovës

përveç detyrave të përshkruara në Akt emërim e ka caktuar "Zyrtar përgjegjës për ndjekjen e procedurave sipas legjislacionit në fuqi për uzurpimin e pronës komunale-objekteve", sipas të cilit vendim ankuesi "ka detyra dhe përgjegjësi të zhvilloj procedurën sipas kërkesës apo detyrës zyrtare që kanë të bëjnë me uzurpimin e pronave publike-komunale siç janë: objektet në pronësi të Komunës së Gjakovës, rrugët lokale dhe ato me vendbanime". Si rezultat i vendimit të datës 08.05.2020 nga ana e Kryetarit të Komunës së Gjakovës, ankuesit i 'u është bere plotësim-ndryshimi përshkrimi i detyrave të reja me datën 19.05.2020 i cili është nënshkruar nga vartësit e tij.

Me datën 20.05.2020, Kryetari i Komunës së Gjakovës me vendim e ka shfuqizuar vendimin paraparak me numër Nr.112/02-10077 me të cilin është caktuar ankuesi si zyrtar përgjegjës për ndjekjen e procedurave të uzurpimit të pronës komunale.

Ankuesi i pakënaqur me detyrat shtese sipas vendimit të Kryetarit të Komunës së Gjakovës, me datën 22.06.2020, ka parashtruar ankese në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Gjakovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i komunës së Gjakovës me datën 24.07.2020, ka nxjerr vendimin me numër 01Nr.070/01-13588, me të cilin ankesën e ankuesit e ka refuzuar si të pabazuar.

I pakënaqur me vendimin me numër 01Nr.070/01-13588 të datës 24.07.2020, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Gjakovës, ankuesi me datën 15.09.2020 ka parashtruar ankese me numër të protokollit 1766/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë: 22.09.2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Gjakovës, ndërsa Komuna e Gjakovës me datën 07.10.2020 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1766/2020 të datës 15.09.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i datës 24.07.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendim i datës 08.05.2020 i Kryetarit të Komunës së Gjakovës; Vendim i datës 20.05.2020 i Kryetarit të Komunës së Gjakovës; Vendim i datës 31.01.2012 i Kuvendit të Komunës së Gjakovës; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 22.09.2020; Përgjigja në ankesë e datës 07.10.2020 nga Komuna e Gjakovës; Akt emërim i ankuesit i datës 12.03.2012; Formulari PDF i datës 19.05.2020 i përshkrimit të detyrave të punës së ankuesit; Kërkesë e ankuesit e datës 08.06.2020; E-maili zyrtar i datës 11.06.2020; E-maili zyrtar i datës 02.07.2020; E-maili zyrtar i datës 20.05.2020; E-maili zyrtar i datës 20.05.2020; Përshkrim i detyrave të punës i datës 19.05.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit [redacted] është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se : Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës

se Gjakovës është i pabaze, i kundërligjshëm ,juridikisht i pavlefshëm dhe si i tille përmban shkelje qenësore dhe është i përfshirë me cenime tw renda tw dispozitave tw procedurës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë te provave te lëndës, ka konstatuar se : Kryetari i Komunës se Gjakovës me rastin e nxjerrjes se vendimit me numër 01Nr112102-10077 te datës 08.05.2020, ka vepruar ne kundërshtim me nenin 47 paragrafin 1 dh nenin 48 te Ligjit Nr.05/ L-031 për procedurën e përgjithshme administrative ne te cilin shprehimisht thuhet se : " **Akti administrativ përmban: 1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes; 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin); 1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjete juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë"**, sepse si vendim është i mangët, dhe ne kuptim te kësaj nuk e përmban pjesën arsyetuese dhe këshillën juridike dhe nuk e sqaron gjendjen faktike se pse është marre një vendim i tille, ngase ne vendim thuhet vetëm se ankuesi "caktohet zyrtar përgjegjës për ndjekjen e procedurave sipas legjislacionit ne fuqi". Andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar që vendimi është dashur ta përmbajë arsyetimin ashtu siç përcaktohet me nenin **48 paragrafin 1 dhe 2 te Ligjit Nr.05/ L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative** ne kuptim te asaj se perse ankuesi është ngarkuar me detyra shtese dhe perse iu është bere plotësim-ndryshimi i përshkrimit të detyrave te punës respektivisht ta arsyetoj vendimin e marre duke e sqaruar gjendjen faktike dhe juridike te situatës edhe nëse ka lindur ndonjë rrethane e re. Po ashtu vendimi si i tille nuk e përmban këshillën juridike dhe si i tille edhe konsiderohet i pavlefshëm dhe nuk prodhon efekt juridik ne një procedure administrative.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se : Vendimi i datës 08.05.2020 me numër 01Nr112102-10077 i Kryetarit te Komunës se Gjakovës po ashtu është nxjerre ne kundërshtim me nenin 10 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe paragrafin 3 te Rregullores 03/2020 për Përshkrimin e detyrave te punës ku thuhet se : " **1. Me aprovimin e zyrtarit me te larte administrativ te institucionit përkatës, një përshkrim i punës mund te ndryshohet dhe plotësohet ne rast te: 1.1 ndryshimeve ne numrin dhe llojin e detyrave,..... 3. Përgatitja, shqyrtimi dhe aprovimi i një përshkrimit te ndryshuar te detyrave te punës dhe propozimi i gradës ne baze te atij përshkrimi behet ne te njëjtën mënyrë sikurse përgatitja, shqyrtimi dhe aprovimi i një përshkrimi te punës për një pozite te re sipas neneve 7 dhe 8 te kësaj rregulloreje"**, sepse plotësim ndryshimi i përshkrimit te detyrave te punës për ankuesin është dashur të bëhet sipas proceduarave ashtu siç përshihet me nenin 7 dhe 8 te Rregullores 03/2020 për Përshkrimin e Detyrave të Punës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ne baze te provave dhe shkresave te lendes ka konstatuar se: Vendimi i Kryetarit te Komunës se Gjakovës i datës 20.05.2020 me numër 01Nr112/02-10585 i cili ka shfuqizuar ne tërësi Vendimin e datës 08.05.2020 me te cilin ankuesit përveç detyrave ne akte emërim është caktuar si "Zyrtar përgjegjës për ndjekjen e procedurave te



uzurpimit të pronës komunale-objekteve", po ashtu ka shfuqizuar të gjitha veprimet që kanë rrjedhe si pasojë e këtij vendimi e që nënkupton që është shfuqizuar edhe plotësimi ndryshimi i përshkrimit të detyrave të punës së ankuesit i datës 19.05.2020, dhe si rezultat i kësaj e gjithë procedura kthehet në piken zero, pra siç ka qenë në gjendjen e mëparshme.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Gjakovës me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër 01Nr.070/01-13588 të datës 24.07.2020, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse nuk ka arritur të vërtetojë drejtë gjendjen faktike dhe juridike kur e ka refuzuar ankesën e ankuesit dhe ka lënë në fuqi përshkrimin e detyrave të punës të datës 19.05.2020.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmarë të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj bazuar në këto rrethana Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.271/20120

Ardita Perguku-Shyti

Procesmbajtëse

Malsore Gashi Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit ██████████
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës:
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjakovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së